



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.687/22 prot.

Datë 05.05.2025

V E N D I M
Nr. 606/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 512/2025, datë 15.04.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Ankimues:

BOE “Rilindje Tiefbau” SHPK me NIPT K83825601K
“Viante Konstruksion” SHPK me NIPT K47103804L dhe “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT K66613407H dhe adresë Lagjia nr. 2, pasuria 4/46+1-9, zona kadastrale 8582, PogradecK63029402A dhe adresë Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katësh, përball Gjimnazit Perikli Ikonomi, Fier

BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k me NIPT K82230002K, & “K.M.K” Sh.p.k me NIPT: L78223801E & “Caushi M” shpk, me NIPT: L88419801O dhe adresë Ballsh Mallakstër, Bulevardi “rrapo Hekali”, shkalla 1, kati 1, z.kadastrale 1090, nr. Pasurie 7/9810

BOE “L.T.E Construction” SHPK me NIPT L78006801F & “Ndregjoni” SHPK me NIPT K31329048I dhe adresë Tiranë, Kashar, Rruga 3 Dëshmorët, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SH.A.
Rr.Muharrem Gega "Nd.24, Hy. 1, Gjirokaster

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datën 15.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 512/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE "Rilindja Tiefbau" SHPK & "Viante Konstruktion" SHPK & "Lis Konstruktion" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur" me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt "Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster" me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE "Eral Construction Company" Sh.p.k & "K.M.K" Sh.p.k & "Caushi M" shpk në procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE "L.T.E Construction" Sh.p.k & "Ndregjoni" Sh.p.k për procedurën e prokurimit të mësipërme.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE Rilindja Tiefbau" SHPK & "Viante Konstruktion" SHPK & "Lis Konstruktion" SHPK, BOE "Eral Construction Company" Sh.p.k & "K.M.K" Sh.p.k & "Caushi M" shpk, si dhe BOE "L.T.E Construction" Sh.p.k & "Ndregjoni" Sh.p.k.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 901 prot., datë 22.04.2025, protokolluar me tonën nr. 687/13 prot., datë 25.04.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A, informon se do të zbatojë plotësisht vendimin nr. 512/2025, datë 15.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjetellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirrokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A.

I.3. Në datën 29.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 574/2025, ku vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjetellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirrokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin nr. 512/224, datë 15.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.4 Me shkresën nr. 984/1 prot., datë 02.05.2025, protokolluar me tonën nr. 687/18 prot., date 05.05.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A, informon se ka zbatuar plotësisht vendimin nr. 512/2025, datë 15.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjetellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirrokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A. Bashkëlidhur ka dorëzuar raportin përmbledhës me nr. 978 prot., datë 30.04.2025 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 984/1 prot., datë 02.05.2025, protokolluar me tonën nr. 687/18 prot., date 05.05.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A, informon se ka zbatuar plotësisht vendimin nr. 512/2025, datë 15.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjetellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirrokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Gjirrokastër SH.A. Bashkëlidhur ka dorëzuar raportin përmbledhës me nr. 978 prot., datë 30.04.2025 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 901 prot., datë 15.04.2025, si dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), rezultoi, se autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SH.A ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit i cili nuk është plotësisht në përputhje me vendimin nr. 512/2025, datë 15.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.512/2025, datë 15.04.2025, konstatoi, se anëtar i KVO-së z. B.T nuk ka pasqyruar saktë në sistem arsyet e skualifikimit të BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK dhe “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Lis Konstruksion” SHPK sipas konstatimeve të vendimit nr. 512/2025, datë 15.04.2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar vendimin nr. 512/2025, datë 15.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Nderim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokastrë” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin nr. 512/2025, datë 15.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

